



Koalicioni për Kosovë të Re (KKR)

Raportet financiare të fushatës dhe Raporti i Auditorëve të pavarur

**Zgjedhjet e jashtëzakonshme nacionale
28 Maj 2014 – 6 Qershor 2014**



Përmbajtja:

Raport i auditorëve të Pavarur.. .. .	3
Pasqyra e Pozitës Financiare.....	5
Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve.....	6
Shënimet e pasqyrave financiare.....	7-17

Raport i Auditorëve te pavarur

Drejtuar Kryesisë së Koalicioni për Kosovë të Re (KKR)

Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike

Mohim i opinionit

Ne kemi qenë të angazhuar për të audituar raportet financiare të fushatës të bashkëngjitura të Subjektit Politik “Koalicioni për Kosovë të Re (KKR)” (në vijim referuar si “Subjekti Politik” apo “KKR”), të përbëra nga Pasqyra e Pozitës Financiare me 6 Qershor 2014, Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve për periudhën 28 Maj 2014 deri me 6 Qershor 2014, dhe informacionin tjetër shpjegues.

Ne nuk shprehim një opinion mbi raportet financiare të fushatës të Koalicionit për Kosovë të Re (KKR). Për shkak të rëndësisë së çështjeve të përshkruara në paragrafin bazat për mohim të dhënies së opinionit, ne nuk kemi qenë në gjendje të sigurojmë evidencën e nevojshme të auditimit për të patur një bazë për një opinion të auditimit.

Bazat për mohim të Opinionit

Subjekti politik nuk ka dorëzuar raportin financiar për periudhën e përfunduar me 6 Qershor 2014 ashtu siç kërkohet me ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar. Ne mungese të raportit financiar ne e kishim të pamundur të japim një opinion mbi pasqyrat financiare të dorëzuara.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre të ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazhduar aktivitetin e saj (parimi i vijimësisë), shpalojshen, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës së kontabilitet sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Subjektin Politik ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Audit& Conto sh.p.k